

**LA 5EME ASSEMBLÉE GÉNÉRALE  
DE  
CCI FRANCE ALBANIE**  
(Chambre de Commerce et d'Industrie France Albanie)  
**26 JANVIER 2017**

**FJALA E KRYETARIT**

-----

\* \* \*

**1. Fjala e mireseardhjes**

\*\*\*

Mirë se vini të gjithë sot në Asamblenë e Përgjithshme të 5-të dhe e hap zyrtarisht këtë Asamble. Një falenderim i madh shkon për të gjithë ju ne kete Asambleje të Përgjithshme vjetore. Unë gjithashtu falenderoj anëtarët e Këshillit Drejtues për bashkëpunimin e tyre të veçantë në krijimin e strukturave, të miratuara gjatë vitit 2016. Ftoj Frédéric Blanc zëvendës kryetari i CCI Francë Shqipëri për përmbledhjen e aktiviteteve të vitit 2016 dhe projektet në vazhdim në vitin 2017;

Pas këtij prezantimi ,Blerina do të vazhdojë me rendin e mbledhjes.

Ju bëj me dije se sot janë të pranishëm 45 anëtarë, quorum-i është arritur dhe ju uroj të gjithëve një bashkëpunim sa më të frytshëm.

\*\*\*

**Të dashur anëtarë, të dashur miq,**

**I Dashur Z. Ambasador, I Dashur Bernard,  
E Dashur Znj. Minisrtre, E Dashur Milena,  
I Dashur Z. Guvernator, I Dashur Gent,**

Ju urojme mireseardhjen te gjithëve dhe ju falenderojme perzermersiht qe keni ardhur sonte ne Asamblene e 5 vjetore te Dhomes.

Ne festojmë 5 vjetorin e krijimit. 4 vjet si Dhomë Tregtie dhe vitin e parë si Klub biznesi. Këto vite nxjerrin në pah qëndrueshmërinë e organizatës, pjekurinë e komunitetit tonë dhe përkushtimin e CCIFA për të punuar në afat gjatë me anëtarët e saj.

Gjatë 2016, kemi patur një mbulim mediatik të konsiderueshëm si me rastin e ndeshjes Francë-Shqipëri, firmosjen e kontratës me Business France, vizitën e personaliteteve: Frederic Mitterrand, Harlem Desir, Jacques Attali, Mme Elisabeth Guigou, Pierre Lignot ... si edhe gjatë disa eventeve të tjera. Për sa i përket komunikimit, shikueshmëria e sitit tonë ka patur rritje të konsiderueshme dhe Buletini Francë- Albanie Express ka arritur të tërheqë lexues të shumtë. 2016 shënoi gjithashtu përdorimin e logos dhe kartografisë se përbashkët duke konfirmuar kështu anëtarësimin tonë në rrjetin e 115 CCIF ndërkombëtare.

CCIFA bashkëpunon me partënerët e saj. Ne kemi krijuar një dialog konstruktiv me AIDA-n, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, me Dhomat e tjera dypalëshe të tregtisë në Shqipëri dhe Dhomat në Francë dhe kjo është shenjë e forcimit të besueshmërisë sonë. Kemi zhvilluar bashkëpunim të qëndrueshëm dhe konstruktiv me autoritetet publike. Ambasada e Francës mbetet gjithmonë miku më i mirë i CCIFA.

\*\*\*

Për të dinamizuar imazhin e Shqipërisë në Francë dhe për të këshilluar kompanitë franceze, ne kemi përmirësuar strategjinë e punës: organizimi i aktiviteve, shkëmbime me rrjetin e CCI në Francë, veçanërisht CCI në Lyon dhe CCI në Normandie. Në bashkëpunim me Business France, u botua edhe një Guidë mbi Shqipërinë. Zyrat tona janë zgjeruar për t'ju përgjigjur sa më mirë nevojave të kompanive Franceze të cilat dëshirojnë të vendosen në Shqipëri dhe ky numër rritet dita dites.

Ne përcojme dijet "savoir faire" të kompanive anëtare dhe bëjmë propozime konkrete për të përmirësuar më tej klimën e biznesit në Shqipëri. Gjatë këtij viti kemi patur më tepër angazhim nga kompanitë anëtare në jetën e CCIFA, pjesmarrje e tyre ka qenë e vazhdueshme në të gjitha eventet e dhomës;

Me qëllim për t'ju përgjigjur sa më mire kerkesave të anëtarëve tanë, 2016 shënoi një etapë të re mbi organizimin e eventeve. Përmendim aktivitetet e organizuara në Paris, "Një ditë mbi tregun Shqipëtar" dhe "Samiti I Ballkanit", apo në Tirane, "Forumi frankofon I biznesit", "Një ditë mbi tregun Francez në Shqipëri"....

CCI France Albanie do të vazhdojë përsëri të jetë aktive dhe prezente mbi ceshtjet kyce që prekin anëtarët tanë me qëllim për t'ju shërbyer sa më mirë atyre dhe të ndihmojmë kompanitë franceze të vendosen në tregun shqiptar.

Se fundmi, falenderojme sponsorat e kesaj mbremjeje. Faleminderit per mbeshtetjen tuaj te vazhdueshme:

MARLOTEX  
EUTELSAT  
MAISON ALBANIE  
HOTEL SHERATON  
GREEN TECHNOLOGIES  
Vila Alejandro  
NAPOLEON WINE & SPIRITS

Mireseerdhet ne Asamblene e pergjithshme 2017 dhe ju uroj nje mbremje te bukur !